

VENDIM
Nr. 312, datë 11.5.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PËRMBAJTJEN E
REGJISTRIT TË *STARTUP*-EVE DHE LEHTËSUESVE, MËNYRËN E
FUNKSIONIMIT DHE NDËRLIDHJEN E TIJ ME PORTALIN QEVERITAR “E-
ALBANIA”, SI DHE PËR DOKUMENTET ELEKTRONIKE – PASAPORTA E
STARTUP-EVE DHE PASAPORTA E LEHTËSUESVE**
(ndryshuar me VKM-në nr. 466, datë 26.7.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 11, të ligjit nr. 25, datë 31.3.2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e regjistrit të *startup*-eve dhe lehtësuesve për mbajtjen e të dhënave të *startup*-eve dhe të lehtësuesve të vetëdeklaruar për kërkesit dhe përfituesit e granteve e të masave mbështetëse nga “*Startup Albania*”.

2. Regjistri i *startup*-eve dhe lehtësuesve, si bazë të dhënash, funksionon, administrohet dhe ndërvepron me bazat e tjera të të dhënave, në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

II. PËRMBAJTJA E REGJISTRIT

1. Të dhënat, që përmban regjistri i *startup*-eve, ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore për *startup*-et do të konsiderohen:

- i. numri unik i identifikimit;
- ii. emri i *startup*-it;
- iii. emri dhe mbiemri i sipërmarrësit;
- iv. numri i pjesëtarëve të *startup*-it;
- v. fusha ku operon;
- vi. faza në të cilën ndodhet *startup*-i;
- vii. përshkrimi i *startup*-it.

b) Të dhëna dytësore për *startup*-et konsiderohen këto të dhëna:

- i. gjenealogjetet e individit (për *startup*-et nisura nga individë);
- ii. të dhënat e regjistrit tregtar për datën e regjistrimit të subjektit, emrin e subjektit/shoqërisë tregtare, numrin unik të identifikimit të subjektit, llojin e shoqërisë tregtare (formën e organizimit të saj), fushën e veprimtarisë dhe misionin e tij/saj, statusin e tij për *startup*-et e nisura nga shoqëri tregtare apo persona fizikë tregtarë;
- iii. kontakte.

2. Të dhënat, që përmban regjistri i lehtësuesve të *startup*-eve, ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhënat parësore për lehtësuesit konsiderohen:

- i. numri unik i identifikimit;

- ii. emri i lehtësuesit;
- iii. të dhënat e përfaqësuesit ligjor;
- iv. data e themelimit;
- v. fusha e veprimtarisë;
- vi. kontakte.

b) Të dhëna dytësore për lehtësuesit konsiderohen, si më poshtë vijon:

- i. gjenealogjia e përfaqësuesit ligjor;
- ii. të dhënat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse/subjektit tregtar/lehtësuesve, data e regjistrimit të organizatës/subjektit, emri i organizatës/subjektit, forma e organizimit të saj/tij, fusha e veprimtarisë dhe misioni i saj/tij, statusi i saj/tij;

- iii. selia/vendndodhja;
- iv. të dhënat e identifikimit të themeluesve;
- v. përshkrimi i shërbimeve që ofron.

III. NDËRLIDHJA ME BAZËN E TË DHËNAVE

1. Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave të grumbulluara bazohet në:

- a) parimin e ndershmërisë, të drejtësisë dhe të ligjshmërisë;
- b) grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë dhe në përputhje me këto qëllime;
- c) saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta të ndryshohen ose të rregullohen;

ç) garantimin e masave teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi;

d) kryerjen e çdo veprimi në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave etj., duke lënë gjurmë me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetin e të dhënave.

2. Të dhënat e mbledhura nga regjistri mund të përdoren për kërkime shkencore e statistikore, analiza, vlerësime apo projekte të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Të dhënat e regjistrimit përditësohen periodikisht nga struktura përgjegjëse, sa herë është e nevojshme, apo ka ndryshime të këtyre të dhënave.

4. Përdoruesit e bazës së të dhënave janë të përcaktuar në 4 nivele:

- a) lexues;
- b) redaktues;
- c) administrator;
- ç) auditues.

5. Subjektet e interesuara për bazën e të dhënave do t'i nënshtrohen nivelit të aksesimit si lexues, sipas ndarjes në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij kreu. Rolet e “redaktuesit”, “administratorit” dhe “audituesit”, ushtrohen nga struktura përgjegjëse pranë “*Startup Albania*”, në përputhje me manualin e përdorimit të regjistrimit që miratohet, sipas pikës 1, të kreut V, të këtij vendimi.

6. Struktura përgjegjëse pranë “*Startup Albania*” do të jetë dhënësi i informacionit për subjektet e interesuara, në pikën 5 të këtij kreu.

7. Baza e të dhënave të regjistrimit të *startup*-eve dhe lehtësuesve ndërvepron nëpërmjet shkëmbimit elektronik të të dhënave me:

- a) bazën e të dhënave shtetërore të regjistrimit tregtar;
- b) bazën e të dhënave të regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse/lehtësuesve;
- c) bazën e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile.

IV. DOKUMENTET ELEKTRONIKE

1. Dokumenti elektronik i pasaportës së *startup*-it gjenerohet nga portali qeveritar “*e-Albania*”, pas plotësimit të formularit të vetëdeklarimit dhe përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) numrin unik të identifikimit të *startup*-it;
- b) emrin e *startup*-it;
- c) numrin personal të *startup*-it, gjeneruar nga plotësimi i formularit të vetëdeklarimit në regjistrin e *startup*-eve;
- ç) vlefshmërinë.

2. Dokumenti elektronik i pasaportës së lehtësuesit gjenerohet nga portali qeveritar “*e-Albania*”, pas plotësimit të formularit të vetëdeklarimit dhe përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) numrin unik të identifikimit të lehtësuesit;
- b) emrin e lehtësuesit;
- c) numrin personal të lehtësuesit, gjeneruar nga plotësimi i formularit të vetëdeklarimit në regjistrin e lehtësuesve;
- ç) vitin e krijimit.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. “*Startup Albania*” është përgjegjës për menaxhimin e regjistrit dhe krijimin e manualit të përdorimit të regjistrit.

2. Ngarkohen “*Startup Albania*” dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama